

V E N D I M

Nr. 55 Date 29.05.2008

PER

FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIMIN E SHOQERISE "ALBANIAN GREEN ENERGY " SH.P.K

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa, a, dhe 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", te ndryshuar, nenit 10 te "Rregullores per Procedurat e Licensimit" te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, dhe nenit 18 pika 3, te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s", miratuar me Vendimin nr.44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.05.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria "Albanian Green Energy" per tu licensuar ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik si dhe prodhimi i energjise elektrike, (Bllok motore-gjeneratore te ushqyer me biomase te lengshme, Shengjin, Lezhe),


Dhe konstatoi paraqitjen, konform percaktimeve te Rregullores se Procedurave te Licensimit, te dokumentacionit dhe deklarave te kerkuara nga ERE kur dokumentacioni mungon,

Vendosi:

1. Të filloj procedurat per licensimin e shoqerise "Albanian Green Energy" sh.p.k. ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik si dhe prodhimin e energjise elektrike. (Bllok motore-gjeneratore te ushqyer me biomase te lengshme, Shengjin, Lezhe).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s,

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i Ere-s
Bujar Nepravishta